

Tiranë, më 02.11.2021

DREJTUAR: STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (SPAK)

PROKURORISË SË TIRANËS

Lënda: Kërkohej verifikimi dhe nisja e hetimeve mbi shpërdorimin me pasoja të rënda të menaxhimit të kaskadës së Drinit në prodhimin, shkëmbimin dhe blerjen e energjisë elektrike me pasoja të rënda dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Të nderuar Prokurorë,

Ne, ashtu si mbarë opinionin publik shqiptar këto ditët e fundit, jemi vënë në dijeni të fakteve të bëra publike në median sociale¹, fakte këto tepër të rënda që lidhen me dy episode të keqmenaxhimit të prodhimit, blerjes, shkëmbimit dhe shpërndarjes së elegjisë elektrike, e që si pasojë mund të kenë sjellë dëme ekonomiko-financiare shumë të mëdha në buxhetin e shoqërisë KESH sh.a., e rrjedhimisht në buxhetin e shtetit shqiptar.

Për qartësi, këto të dhëna të bëra publike pasqyrojnë dy episode si më poshtë vijon:

Episodi 1

Konkretisht nga të dhënat e publikuara si një publikim ekskluziv i rrjetit social www.mcntv.al dhe www.syri.net, publikime të cilat gjenden lehtë, por që gjithsesi po jua servirim në linqet më poshtë dhe bashkëlidhur kësaj kërkesë rezulton se:

¹ <http://www.mcntv.al/2021/10/25/ekskluzive-si-u-vodh-kaskada-e-drinit-n-kulmin-e-kriz-s>

<https://www.syri.net/politike/459164/kur-rama-kercenonte-shqiptaret-per-dritat-vidheshin-miliona-euro-energji-nga-hec-et-e-drinit/>

<https://www.hashtag.al/index.php/2021/10/24/benet-be-ci-ne-afere/>

Ndërkohë që në 3 tetor 2021 kryeministri Edi Rama paralajmëroi shqiptarët se mbi supet e tyre do të binte një tjetër barrë e rëndë, ajo e krizës energjetike, një ditë pas kësaj deklarate në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare po zhvillohej një operacion i shkëmbimit të enegjisë elektrike që paraqet hije të rënda të veprës penale të korrupsionit pasiv që siç evidentohet dhe në publikim, ky veprim po kamuflohej në kuadrin e shkëmbimit të energjisë elektrike.

Ndër të tjera, në publikimin ekskluziv të MCN evidentohen oraret sekrete të shkëmbimit, që tregojnë se si është vjedhur e shpërdoruar energjia elektrike nga KESH sh.a., përmes një kontrate shkëmbimi, që duket se ka favorizuar kompaninë e përfshirë në këtë operacion, duke dëmtuar interesat e kompanisë shtetërore KESH sh.a.

Bëhet fjalë për një kontratë mes KESH sh.a. dhe kompanisë private NOA Energy, e cila *de facto* përbën një nga skemat më të mëdha të korrupsionit në sistemin energjetik të vendi.

Në 4 tetor, pra të nesërmen e deklaratës së kryeministrit, nga ora 17:00 deri në orën 23:00 të mbrëmjes KESH i ka dhënë kompanisë NOA, saktësisht 1807 megavat energji.

Siç tregohet nga tabela në foto më poshtë, energjia është dorëzuar e gjitha në periudhën pikut, ku çmimi në bursën hungareze për ato orë në atë datë ka variuar nga 206 deri në 271 euro për megavat.

Në të njëjtën ditë, NOA i ka kthyer KESH-it mbrapsht 817 mega vat energji, por kthimi i energjisë është bërë nga ora 1 e natës deri në 6 të mëngjesit. Në orët që NOA i ka kthyer energjinë KESH-it, cmimi në bursë në atë datë ka variuar nga 50 deri në 150 euro për mega.

Energjia e dhene nga KESH				Energjia e kthyer nga NOA			
Data 4 tetor				Data 4 tetor			
Ora	Sasia MW	Cmimi euro/MW	Vlera euro	Ora	Sasia MW	Cmimi euro/MW	Vlera euro
17:00-18:00	305	225.42	68753.1	01:00-02:00	133	51.99	6914.67
18:00-19:00	305	254.97	77765.85	02:00-03:00	173	54.16	9369.68
19:00-20:00	305	271.28	82740.4	03:00-04:00	170	51.94	8829.8
20:00-21:00	305	234.24	71443.2	04:00-05:00	173	54.89	9495.97
21:00-22:00	300	219.43	65829	05:00-06:00	168	150.31	25252.08
22:00-23:00	287	206.38	59231.06				
Totali	1807 MW		425762.61 euro	Totali	817 MW		59862.2 euro

E njëjta skemë identike është aplikuar çdo ditë nga qershori deri në tetor. KESH i ka dhënë energji NOA-s në periudhën pik, kur cmimet janë në stratosferë. NOA këtë energji e shet me çmim të lartë dhe më pas e blen gjatë natës me çmim të lirë për t'ja kthyer KESH-it.

Për periudhën nga 1 tetori deri në 13 tetor KESH i ka dhënë NOA-s në total 10 mijë e 417 mega vat energji, të cilat në orët e dorëzuar sipas çmimeve në bursë kanë patur një vlerë totale prej 2 milionë 620 mijë eurosh. Për të njëjtën periudhë NOA i ka kthyer KESH-it mbrapsht energjinë, e cila në oraret kur është dorëzuar ka patur një vlerë totale prej 1 milionë 557 mijë euro. Pra në vetëm 10 ditë shkëmbime, Kaskadës së Drinit i janë vjedhur gati 1 milionë e 100 mijë euro.

Shkëmbimi i energjisë mes KESH dhe NOA ka vazhduar nga qershori deri në gjysmën e tetorit. Madje dy javë pasi kryeministri përbetohej se qeveria do ta menaxhonte krizën në mënyrën më të mirë dhe një javë pasi qeveria kishte shpallur gjendjen e emergjencës energjetike KESH dhe NOA shkëmbejnë energji. Me të njëjtën skemë identike. KESH i ka dhënë NOA-s energji në periudhën pik, dhe e ka marrë atë mbrapsht në orët e natës dhe në fundjave, ku cmimet janë minimale. Me pak fjalë, kjo kontratë ka vënë në funksion të një kompanie private asetin më të rëndësishëm strategjik të vendit, kaskadën e Drinit.

Kontrata e shkëmbimit të energjisë është iniciuar nga ish drejtori i KESH, Benet Beci që sot mban postin e deputetit për Partinë Socialiste. Por firmën finale në të e ka hedhur Besian Kadiu, i cili u komandua në krye të KESH për një periudhë të shkurtër, pasi Benet Beci kandidoi për deputet. Kjo kontratë, implikon disa zyrtarë dhe institucione njëherësh, përfshirë Autoritetin e Konkurrencës.

Sa më sipër, nëse ky informacion rezulton i vërtetë, të gjithë personat e përfshirë duket se kanë mundësuar një nga skemat më të mëdha të vjedhjes që është bërë ndonjëherë në sektorin energjetik të vendit. Një gjakderdhje e mirëfilltë financiare, e cila i ka marrë qytetarëve shqiptarë në kulmin e krizës energjetike minimalisht 5 milionë euro. Megjithatë dëmi real që ajo ka bërë është shumë më i madh se kaq. Tashmë Spak gjendet përballë provave flagrante, mjafton të sekuestrojë në OST profilet e shkëmbimit të energjisë, nga qershori deri në 17 tetor.

Episodi 2

Nga të dhënat e publikuara në rrjetin social hashtag.al publikime të cilat gjenden lehtë, por që gjithsesi po jua servirim në linqet më poshtë dhe bashkëlidhur kësaj kërkesë rezulton se:

Ish-drejtori i KESH Benet Beci dhe ish-drejtoresha Erideta Bashi rezultojnë të përfshirë drejtëpërdrejtë në veprimtari të paligjshme gjatë një bashkëveprimi me kompaninë serbe N4T (NetworkForTrading), nga ku sipas asaj që bëhet publike rezulton që shteti shqiptar ka humbur rreth 2.6 milionë euro që duhej të ishin arkëtuar menjëherë nga KESH-i.

Nga një dokument i siguruar dhe i publikuar nga Hashtag.al, është zbuluar se kompania serbe falë veprimeve apo mosveprimeve të zyrtarëve përkatës ka arritur t'i shvasë shtetit shqiptar shumë prej 2.6 milion euro, gjë e cila nuk do të ndodhte nëse zyrtarët ku përfshihet dhe deputeti aktual i Partisë Socialiste dhe ish-Drejtori i KESH do të kishin ushtruar në mënyrë korekte detyrën dhe do të kishin respektuar kushtet e kontratës për ndërprerjen e menjëhershme të shitjes në rast të mos pagesës së garancisë nga ana e kompanisë blerëse.

Sipas asaj që është publikuar, z.Benet Beci u tërhoq formalisht nga drejtimi i KESH-it pak javë para zgjedhjeve të 25 Prillit, ndërkohë që ai komandoi një tjetër drejtues në krye të KESH, por përgjatë fushatës elektorale e deri në korrik 2021, ishte Beci ai që kontrollonte sidomos aktivitetin tregtar të KESH-it.

Nga një shkresë konfidenciale të drejtorit të ri të shitjeve, në kompaninë shtetërore zbulohet se mosveprimet e zyrtarëve të denoncuar publikisht kanë çuar në përfitime kolsoale nga kompania serbe. Për më tepër, publikimi bashkëlidhur.

Nga të dy këto episode, rezulton se kanë qënë pikërisht veprimet dhe mosveprimet sipas ligjit, të zyrtarëve të sipërcituar, që kanë shkaktuar dëme financiare në terma konkretë dhe që mund të përmbajnë elementë të disa figurave të veprave penale (pa u kufizuar vetëm në to):

- Shpërdorimi i detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv dhe aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga nenet 244, 259, të Kodit Penal;
- Vjedhje e pasurisë së shtetit, duke shpërdoruar detyrën, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 135, i Kodit Penal;
- Falsifikimi i dokumenteve, parashikuar nga neni 186, i Kodit Penal;

- Moskallëzim i krimit, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal;
- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal.

Në këtë veprimtari, sipas fakteve të publikuara, janë të përfshirë si punonjës hetimi i veprimeve të të cilëve është në kompetencë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu dhe vepra dhe zyrtarë, hetimi i të cilëve është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Rëndësia e këtyre fakteve të bëra publike nga media, na bën të detyruar t'ju drejtohem, me qëllim që nga hetimet që do të kryeni të ndani kompetencën lëndore midis jush.

Duke vlerësuar faktet dhe të dhënat e bëra publike në lidhje me këtë megaskandal, kërkojmë që, SPAK, të nisë pa vonesë hetimet, të marrë masat e nevojshme për të administruar dhe sekuestruar të gjitha provat që faktojnë këtë veprimtari të paligjshme, por dhe për të frenuar dhe ndaluar abuzimin që po kryhet me pasurinë kombëtare të shtetit shqiptar, dhe të mos degjenerojë që gjithë gropat financiare që mund të ketë prodhuar kjo veprimtari e paligjshme t'u ngarkohen taksapaguesve dhe bizneseve shqiptare, duke rritur çmimin e energjisë elektrike.

Është e pamoralshme që t'u kërkosh shqiptarëve dhe biznesit vendas apo të huaj, rritje të energjisë elektrike, shpikjen e një krize në sektorin e energjisë në mënyrë të papritur, ndërkohë që shkaktari kryesor i kësaj situatë, nëse këto fakte vërtetohen, i bie të jenë vet menaxherët publik përmes këtyre shpërdorimeve kaq të rënda.

Me respekt,

Deputetët e Kuvendit të SHQIPËRISË

Petrit VASILI

Erisa XHIXHO